

20231011914

Në bazë të nenit 92, paragrafi (6) dhe nenit 97 të Ligjit të Sigurimit Pensional Vullnetar me Financim Kapital („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 7/2008, 124/2010, 17/2011 dhe 13/2013 dhe Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut 103/2021) Këshilli i Ekspertëve të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Financimit Kapital të Sigurimit Pensional në mbledhjen e mbajtur më datë 27.4.2023 miratoi

RREGULLORE PËR MËNYRËN DHE KOHËN E TRANSFERIMIT TË MJETEVE TE FONDET PENSIONALE VULLNETARE

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen më afërsisht:

a) Koha dhe mënyra e transferimit të mjeteve të nxënësit në skemën pensionale profesionale të cilit i është ndërprerë marrëdhënia e punës ose anëtarësimi te një sigurues dhe nëse siguruesi e anulon skemën pensionale profesionale dhe

b) Mënyra dhe data e transferimit të mjeteve ndërmjet fondeve pensionale vullnetare me të cilat menaxhojnë shoqëri të ndryshme për menaxhim me fondet pensionale vullnetare dhe/ose shoqëritë për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale vullnetare (në tekstin e mëtutjeshëm: shoqëritë) dhe llojin e të dhënave që dorëzohen.

Transferimi i mjeteve nga njëra llogari në tjetrën llogari individuale vullnetare

Neni 2

Mjetet nga llogaria individuale vullnetare në një fond pensional vullnetar transferohen në llogari individuale vullnetare në fond tjetër pensional vullnetar, kur anëtari i fondit pensional vullnetar ekzistues bëhet anëtar me lidhje të kontratës për anëtarësim në fond pensional vullnetar në përputhje me ligjin.

Transferimi i mjeteve nga njëra në tjetër llogari profesionale ose nga ajo profesionale në llogari individuale profesionale

Neni 3

(1) Mjetet e pjesëmarrësit në skemën pensionale profesionale të cilit i është ndërprerë marrëdhënia e punës te punëdhënësi ose anëtarësimi në shoqatën e qytetarëve që është organizator i skemës pensionale profesionale transferohen:

a) nga njëra llogari në tjetër llogari profesionale, nëse siguruesi i ri ku është punësuar anëtari ka skemë të organizuar pensionale profesionale dhe anëtari është pjesëmarrës në skemën;

b) nga llogaria profesionale në llogari individuale vullnetare nëse anëtari ka llogari individuale vullnetare dhe nëse siguruesi i ri ku është i punësuar anëtari nuk ka organizuar skemë pensionale profesionale ose anëtari nuk është pjesëmarrës në skemën të cilën e ka organizuar siguruesi i ri; dhe

c) nga llogaria profesionale në llogarinë individuale vullnetare nëse shoqëria i hap llogari individuale vullnetare anëtarit, pas informatës së marrë nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Financimit Kapital të Sigurimit Pensional (në tekstin e mëtutjeshëm: Agjencia).

(2) Mjetet e pjesëmarrësit në skemën pensionale profesionale transferohen nga njëra llogari në llogarinë tjetër profesionale në rast të transferimit të skemës pensionale profesionale nga njëri fond në tjetrin fond pensional vullnetar.

(3) Kur anëtari i fondit pensional vullnetar është pjesëmarrës në dy skema pensionale profesionale mjetet transferohen nga njëra llogari në llogarinë tjetër profesionale në fondin pensional vullnetar i cili është zgjedhur nga anëtari. Nëse anëtari, në afat prej 90 ditësh nga njoftimi nga shoqëria që menaxhojnë fondet pensionale nuk zgjedh fond pensional vullnetar, mjetet transferohen nga njëra në tjetrën llogari profesionale në fondin pensional vullnetar në të cilin është kryer pagesa e parë.

Mënyra dhe koha e transferimit të mjeteve

Neni 4

Shoqëria që menaxhon fondin e përhershëm pensional vullnetar, i transferon mjetet nga llogaria individuale vullnetare e anëtarit në fondin e ardhshëm pensional vullnetar në datën e parë të transferimit që vijon, pas dorëzimit të njoftimit dhe dëshmisë për kompensim pagesor për kalim.

Neni 5

Në rast të nenit 3, paragrafi (1), pika a) të kësaj rregulloreje, shoqëria që menaxhon fondin pensional vullnetar në të cilin anëtari ka llogari profesionale, i transferon mjetet në llogarinë profesionale në fondin pensional vullnetar në të cilin mbahet skemë pensionale profesionale të siguruesit të ri në datën e parë të transferimit që vijon, pas datës së përfshirjes në skemën pensionale profesionale të siguruesi i ri.

Neni 6

Në rast të nenit 3, paragrafi (1), pika b) të kësaj rregulloreje:

a) shoqëria e cila menaxhon fondin pensional vullnetar në të cilin anëtari ka llogari profesionale, i transferon mjetet në llogarinë individuale vullnetare të anëtarit në datën e parë të transferimit që vijon, pas kërkesës së anëtarit për transferim të mjeteve të tij;

b) nëse personi në afat prej 90 ditësh nga pjesa e mbetur e marrëdhënies së punës ose anëtarësisë në shoqatën e qytetarëve, nuk bëhet pjesëmarrës në skemën profesionale të sigurues tjetër dhe ka llogari individuale vullnetare në fondin pensional vullnetar në të cilin ka llogari profesionale, shoqëria e cila menaxhon me atë fond pensional vullnetar, i transferon mjetet nga llogaria profesionale në llogarinë individuale vullnetare në datën e parë të transferimit që vijon, pas kalimit të 90 ditëve nga kjo pikë; dhe

c) nëse personi, në afat prej 90 ditësh nga pjesa e mbetur e marrëdhënies së punës ose anëtarësisimit në shoqatën e qytetarëve, nuk bëhet pjesëmarrës në skemën profesionale të sigurues tjetër dhe nuk ka llogari individuale vullnetare në fondin pensional vullnetar në të cilin ka llogari profesionale, shoqëria e cila menaxhon me atë fond vullnetar pensional, i transferon mjetet nga llogaria profesionale në llogarinë individuale vullnetare në datën e parë të transferimit që vijon, pas marrjes së informatës nga Agjencia, për fondin pensional vullnetar në të cilin anëtari ka llogari individuale vullnetare.

Neni 7

Në rast të nenit 3, paragrafi (1), pika c) të kësaj rregulloreje, shoqëria e cila menaxhon fondin pensional vullnetar në të cilin anëtari ka llogari profesionale, pas marrjes së informatës nga Agjencia se anëtari ka llogari individuale vullnetare, menjëherë hap llogari individuale vullnetare dhe i transferon mjetet nga llogaria profesionale në llogarinë individuale vullnetare në datën e parë të transferimit që vijon, pas hapjes së llogarisë.

Neni 8

Në rast të nenit 3, paragrafi (2) të kësaj rregulloreje shoqëria e cila menaxhon fondin pensional vullnetar ekzistues, në të cilin anëtari ka llogari profesionale, i transferon mjetet në llogarinë profesionale në fondin e ardhshëm pensional në datën e parë të transferimit që vijon, pas nënshkrimit të kontratës për organizim dhe financim të skemës pensionale profesionale ndërmjet siguruesit dhe shoqërisë që menaxhon fondin e ardhshëm pensional vullnetar.

Neni 9

Në rast të nenit 3, paragrafi (3), të kësaj rregulloreje:

a) Shoqëria që menaxhon fondin pensional vullnetar, që nuk është zgjedhur nga anëtari, në të cilin është përfshirë skema pensionale profesionale, i transferon mjetet në llogari profesionale në fondin pensional vullnetar që është zgjedhur nga anëtari në datën e parë të transferimit që vijon, pas zgjedhjes.

b) Nëse anëtari nuk zgjedh fond pensional vullnetar, shoqëria e cila menaxhon fondin pensional vullnetar në të cilin nuk është bërë pagesa e parë, i transferon mjetet e llogarisë profesionale në fondin pensional vullnetar në të cilin është bërë pagesa e parë në datën e parë të transferimit që vijon, pas skadimit të 90 ditëve nga njoftimi i Agjencisë.

Neni 10

Data e transferimit është çdo ditë të fundit në muajin.

Neni 11

Shuma e mjeteve e cila transferohet përllogaritet sipas vlerës së njësisë kontabël në ditën e cila i paraprin datës së transferimit.

Neni 12

(1) Së bashku me mjetet që transferohen, shoqëria e cila menaxhon fondin pensional vullnetar ekzistues, i transferon në fondin e ardhshëm pensional vullnetar të gjitha të dhënat e lidhura nga llogaria profesionale, përkatësisht llogaria individuale vullnetare.

(2) Shoqëritë ndërmjet tyre merresh vesh për mënyrën e barazimit të mjeteve dhe transferimin e të dhënave në datën e transferimit.

(3) Transferimi duhet të bëhet në kushte të cilat ofrojnë siguri dhe mbrojtje të të dhënave nga llogaria profesionale, përkatësisht llogaria individuale vullnetare.

Neni 13

(1) Në datën e transferimit shoqëria e njofton ruajtësin e pronës dhe jep urdhër për transferim të shumës neto të cilën njëra shoqëri duhet ta transferojë në fondin tjetër pensional vullnetar, në bazë të përllogaritjes së bërë.

(2) Në bazë të urdhëresës, ruajtësi i pronës menjëherë e transferon shumën e nevojshme neto në llogarinë e fondit të ardhshëm pensional vullnetar.

(3) Shoqëritë dorëzojnë njoftim në Agjencinë në lidhje me transferimin e kryer të të dhënave dhe mënyrën e barazimit të mjeteve në ditën e fundit të muajit. Njoftimi në Agjencinë i përmban të dhënat e cekura në Raportin për transferim të mjeteve në përputhje me Udhëzimin teknik për dorëzim të arkivit vjetor dhe të raporteve nga bazat e të dhënave të cilat i mbajnë shoqëritë pensionale.

Dispozita përfundimtare

Neni 14

(1) Kjo rregullore hyn në fuqi një dit pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Me hyrje në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për mënyrën dhe kohën e transferimit të mjeteve të fondeve pensionale vullnetare (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 138/2008).

Nr. 01-677/3
28.4.2023
Shkup

Kryetar
i Këshillit të Ekspertëve,
Maksud Ali, d.v.